



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**



Në bazë të nenit 17, pika (k), nenit 40, pika (c) të Ligjit nr. 03/ L - 040 për vetëqeverisje lokale, të nenit 5, paragrafi 4.1 dhe nenit 6, paragrafi 2 të Ligjit nr. 08/L-255 për shërbime sociale dhe familjare, si dhe të nenit 34, paragrafi 34.1, pika (d) dhe nenit 33, paragrafi 33.1, pika (c) e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit në mbledhjen e mbajtur më 24.4.2024, merr këtë:

**V E N D I M**  
**PËR MBËSHTETJE FINANCIARE TË SHËRBIMEVE SOCIALE**  
**PËR FËMIJË ME AFTËSI TË KUFIZUARA**

**I.**

MIRATOHET Vendimi për mbështetje financiare të shërbimeve sociale për fëmijë me aftësi të kufizuara.

**II.**

Shuma e mjeteve të ndara, sipas pikës I të këtij vendimi, është 41,720.00€ (dyzet e njëmijë e shtatëqind e njëzet euro), shumë kjo e siguruar nga kategoria e subvencioneve nga Drejtoria e Mirëqenies Sociale.

**III.**

Qëllimi i këtij vendimi është ndarja e mjeteve financiare për "Handikos - Shoqata e Paraplegjikëve dhe Paralizës së fëmijëve të Kosovës", të cilat Komuna e Prishtinës i ndan si mbështetje financiare për t'i mbështetur shërbimet sociale për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuara.

**IV.**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Kryeqytetit, Drejtoria e Mirëqenies Sociale dhe Drejtoria e Financave.

V.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT  
01-450/03-54429/ 24, më 26.4.2024

KRYESUESI I KUVENDIT  
Fehmi Kripina

